



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administratës Publike /Ministarstvo za Javne Uprave /
Ministry of Public Administration

DATË/A:	11.05.2018
REFERENC-Ë:	ZVM
PËR/ZA/TO:	z. Ramush Haradinaj - Kryeministër - ZKM
CC:	z. Besnik Tahiri - Koordinator Nacional për Reforma në AP
NGA/OD/FROM:	Bujar Nerjovaj - Zëvendësministër i MAP-it
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti një mujor

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj

Po iu paraqes një raport mujor të punës sime që nga emërtimi im si zv.Ministër në Ministrinë e Administratës Publike, si në vijim;

RAPORT

I punës dhe angazhimit zv. të Ministrit të Ministrisë së Administratës Publike , Bujar Nerjovaj

I nderuar Kryeministër , **Java e parë** e punës ka qenë kryesisht javë e përmbushur me takime njohëse me ministrin z. Mahir Yagcilar , sekretarin permanent të MAP-it z Arton Berisha , drejtor të departamenteve të ministrisë së Administratës Publike të Kosovës.

Temat ishin :

- 1.Njohja me stafin
- 2.Sfidat nëpër departamente dhe planprogramet
- 3.Kërkesat dhe nevojat për ndryshim dhe intensifikim të punëve
- 4.Funksionimi më i mirë ndër sektorial

Java e dytë filloj me ndarjen e detyrave për mua si zv. Ministër i MAP-it.

Në këtë takim ministri z.Mahir Yagcilar ,më ndau si resor IKAP-in që unë t`a mbikëqyri dhe të mundohemi me gjetë një bashkpunim dhe punë të përbashkët për avancimin e Institutit për Administratë Publike të Kosovës në funksionalitetin ,rritjes

së kapaciteteve dhe zbatimit të politikave rreth avancimit të kualitetit të shërbimeve që ofron ky institut.

Në ditët në Vazhdim pata takime njohëse për mua me Drejtoreshën e IKAP-it znj.

Refike Sylcevsji, Udhëheqësit e departamenteve z.Bujar Thaqi dhe z.Enver Haxhiaj.

Tema të këtij takimi ishin :

1. Planprogramet (Kurrikulat)
2. Sfidat rreth realizimit
3. Natyra e funksionimit dhe buxheti
4. Organizatat partnere që ndihmojnë IKAP-in

Java e tretë Ishte më intensive në punën time,për arsye se filluam të intensifikojmë takimet dhe ftova në takim edhe përfaqësuesin e GIZ-it si donatorë kryesor për të bashbiseduar. Në këtë Takim ishin edhe përfaqësuesit e IKAP-it.

Temat ishin:

1. Bashkpunimi GIZ-i - IKAP dhe përkrahja e tyre
2. Problemet me sigurimin e sallave për trajnim dhe kushteve
3. Nevoja për intensifikimin e planit dinamik për ndërtimin më të shpejt të ndërtesës së IKAP-it
4. Cilësia e ofrimit të trajnimeve nga IKAP dhe ngritja e saj
5. Mënyrat e përzgjedhjes së trajnerëve dhe krijimi i një dokumenti për shmangien e gabimeve në përzgjedhje
6. Eliminimi i mëdyshjeve në relacionin IKAP - MAP

Gjatë kësaj jave pata edhe dy takime me :

1. Agjensionin e Inspektoratit të Policisë së Kosovës dhe
2. Avokatët ligjor të komunave : Gjakovë,Fushë Kosovë dhe Skenderaj

Tema të takimeve ishin:

1. Ligji i ri i pagave dhe
2. Pakënaqësit e tyre për mos barazi në mes të përfaqësuesve ligjor të komunave dhe shtetit dhe
3. A , kanë hy si pjesë e ligjit edhe rekomandimet e IPK -së.

I sygjerova që të shfrytëzojnë komunikimin direkt me Drejtinë përkatëse brenda MAP-it dhe nëse ka nevojë të aranzhoj një takim dy palësh.

Këtë javë përfaqësova edhe ministrinë tonë në mbledhje të qeverisë pasi që ministri ishte jashtë vendit (Mal të Zi) në takim me RESPA-në, **edhe pse sygjerimi im ishte të**

Java e katërt : Pata takim in e rregullt me ministrin z.Mahir Yagcilar dhe e vura në dijeni për një rregullore të IKAP-it e cila rregullon angazhimin , kushtet e punës dhe mënyrat e pagesës së trajnerëve, përzgjedhjen dhe kriteret dhe si e tillë të kthehet edhe një herë në bazë për t`u eliminuar vërejtjet e dhëna nga auditori i brendshëm dhe jashtëm si dhe nga Raporti i Progresit.

Prandaj këtë javë organizova takim in mes IKAP-it dhe Departamentit ligjor të MAP-it në plotësimin dhe evitimin e mangësive të cekura më lart. Patëm dy takime shumë të frytshme dhe besoj që brenda javës së ardhshme do të kemi gati dokumentin.

Gjatë javës pata takime me grupe të interesit që punojnë në Administratë Publike të Kosovë por edhe Administratë Lokale rreth vërejtjeve dhe sygjërimeve për ligjin mbi pagat.

Prishtinë me 11.05.2018

Zv. Ministri : Bujar Nerjovaj